



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljenor/Prodato Received/Delivuty	14. 04. 2022	viti god year	2
Organ /Njësia Organ /Jedimica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDM8HUK	2121/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.192/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.192/2022 të datës 01.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike „kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 13.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.192/2022 e datës 01.03.2022, e parashtruar nga ankuesi

II **Obligohet** Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për zbatim të këtij vendimi, duke bërë kompensimin e diferencës së koeficientit nga 5.5 në 7 dhe atë nga data 01.05.2017 deri më datë 13.01.2022.

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Prishtinës, në pozitën Zyrtar për Vlerësimin e Pronës, sipas Akt emërimit të datës 14.01.2022, më datë 01.03.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:1089/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes së datës 21.02.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 04.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese në Komunën e Prishtinës. Ndërsa me datë 18.03.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankese së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 01.03.2022 me numër protokolli 1089/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 01.06.2017 me numër protokolli 2570/2017 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi A.nr.02/581/2017 i datës 20.10.2017 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimi i datës 17.05.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktvendimi A.nr.1039/19 i datës 17.03.2020 i Gjykatës të Apelit në Prishtinë; Urdhër për përmbarim i datës 19.01.2021; Procesverbal i seancës dëgjimore i datës 11.01.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; E-mail zyrtar i datës 18.01.2022; Vendimi i datës 14.01.2022 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Akt emërimi i datës 14.01.2022; Kërkesë për kompensimin e diferencës në pagë e datës 18.01.2022; Përgjigje në kërkesë e datës 21.02.2022; Propozim për përmbarim i datës 22.11.2017; Akt emërimi i datës 01.02.2017 me nr.01 nr.112-352; kopja e letërnjoftimit; Përgjigje në ankese e datës 18.03.2022 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar *sepse*:

Bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, Komuna e Prishtinës bazuar në Vendimin për Organizimin, Kompetencat, Përgjegjësit dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Administratës Komunale të datës 19.01.2016, më datë 01.02.2017 ka bërë lëshimin e Akt Emërimit për ankuesin në pozitën Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme, të cilin ankuesi e ka nënshkruar më datë 18.04.2017. Ankuesi kundër këtij akt emërimi, ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.10.2017 ka nxjerr Vendim A 02/581/2017 me të cilin ka aprovuar ankese e ankuesit duke e obliguar Kryetarin e Komunës që të bëjë plotësim ndryshimin e aktit të emërimit duke marrë për bazë kualifikimin, përvojën dhe përshkrimin e vendit të punës së ankuesit.

Ankuesi më arsyetimin që nuk është zbatuar Vendimi A 02/581/2017 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka filluar procedurën për përmbarimin e këtij vendimi, ku Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin Cp.nr.1870/17 ka lejuar përmbarimin e këtij vendimi, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendim Ac.nr.1039/19 ka aprovuar si të themeltë ankese e ankuesit duke e kthyer lëndën në gjykatë për procedim të serishëm. Gjykata Themelore në Prishtinë më datë 19.02.2021 ka nxjerr Urdhër për Përmbarim me numër Cp.nr.1870/17 me të cilin ka urdhëruar Komunën e Prishtinës që të përmbaroj Aktvendimin Cp.nr.1870/17 të datës 07.05.2018. Në bazë të Procesverbalit të datës 11.01.2022 të seancës dëgjimore për rastin Cp.nr.1870/17 i jepet afat debitorit për zbatimin e urdhrit për përmbarime të datës 19.02.2021. Komuna e Prishtinës më datë 14.01.2022 ka nxjerr Vendim me

Nr. 14-112/02-8298/22 me të cilin ka zbatuar urdhër për përmbarim të Gjykatës Themelore në Prishtinë Cp.nr.1870/17 duke bërë ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit për ankuesin nga pozita Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme në Zyrtar për Vlerësimin e Pronës, ku në bazë të kësaj më datë 14.01.2022 ankuesit i është lëshuar Akt Emërimit me koeficient shtatë (7).

Ankuesi më datë 18.01.2022 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore për kompensimin e diferencës së koeficientit nga 5.5 në shtatë për periudhën maj 2017 deri më datë 14.01.2022. Menaxheri i Burimeve Njerëzore përmes përgjigjes së datës 21.02.2022 ka njoftuar ankuesin që urdhri për përmbarim nuk ka përfshirë ngritjen e koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Urdhri për Përmbarim me numër Cp.nr.1870/17 ka obliguar vetëm të bëhet përmbarimi i Vendimit A 02/581/2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që meqenëse Komuna e Prishtinës ka përmbaruar këtë vendim dhe tashmë paguhem me koeficient shtatë (7), atëherë kjo nënkupton që për pjesën nga data 31.05.2017 deri më datë 31.01.2022 të bëhet pagesa e diferencës së koeficientit nga 5.5 në 7.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar Vendimit A 02/581/2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin është përcaktuar qartë se me Vendimin me numër 01 Nr. 031-13761 të datës 19.01.2016 për Organizimin, Kompetencat, Përgjegjësitë dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Administratës Komunale, nuk është përcaktuar sistematizimi i vendeve të punës së nëpunësve civil në administratën komunale të Prishtinës, por vetëm janë paraparë strukturat organizative, respektivisht Drejtoritë dhe Sektorët në kuadër të administratës, sepse ky vendim nuk përmban asnjë dispozite me të cilën sanksionohet ndryshimi i pozitave brenda administratës, respektivisht nuk kemi asnjë bazë ligjore me të cilën do të dëshmohej se pozita e mëparshme e ankuesit është shuar, ndërsa pozita e re është pozitë e përcaktuar në aktin mbi bazën e se cilës është bërë sistemimi i ankuesit, si rrjedhojë përderisa ka qenë kjo paqartësi e sistemimit të ankuesit, atëherë nuk ka mund të bëhet ky sistemim, duke marr për bazë edhe faktin që nuk mund të bëhet prekja e pagës së ankuesit.

Duke marr parasysh faktin që me Urdhrin për Përmbarim me numër Cp.nr.1870/17 të datës 19.02.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, është obliguar Komuna e Prishtinës që të përmbaroj Vendimin A 02/581/2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, atëherë Komuna e Prishtinës me rastin e përmbarimit të këtij urdhri sipas Vendimit me Nr. 14-112/02-8298/22 të datës 14.01.2022, ka nxjerr edhe Akt Emërimit për ankuesin me koeficient shtatë(7), çka nënkupton se pozita Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme me pozitën Zyrtar për Vlerësimin e Pronës janë pozita të barasvlershme dhe për të dyja pozitat koeficienti është shtatë (7).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se deri në kohën e përmbarimit e Urdhrit për Përmbarim me numër Cp.nr.1870/17 të datës 19.02.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, konstaton se ankuesi është paguar me koeficient 5.5, ndërsa pas përmbarimit të

Vendimit A 02/581/2017 të Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, atëherë për ankuesin ka ndryshuar edhe koeficienti në shtatë (7).

Sipas nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/1-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, është përcaktuar që: "Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë", po ashtu sipas paragrafit 4 të këtij neni, përcaktohet që: "Nëpunësit civil kanë të drejtë në pagën e garantuar, në përputhje me dispozitat e përgjithshme të punës", kështu që pretendimet ankimore të ankesës janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare me rastin e shqyrtimit të lëndës, konstaton se Komuna e Prishtinës, është e obliguar që ankuesit ti bëjë kompensimin e diferencës së pagës nga koeficient 5.5 në 7 për periudhën nga data 01.05.2017 deri më datë 13.01.2022, ndërsa kjo periudhë bazohet në listën e pagave të muajit Maj 2017 si dhe në vendimin Nr. 14-112/02-8298/22 të datës 14.01.2022.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit do të ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Nga sa u tha me lartë konform dispozitave të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.192/2022, datë 13.04.2022

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- ❖ Arkivit të KPMShCK-së

